



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

23 prill 2026

I nderuar Minister i Financave, z. Murati,
I nderuar Sekretari i Përgjithshëm, z. Ahmeti,
I nderuar Drejtor i Departamentit të Buxhetit, z. Elmazi,

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), me respekt, ju drejtohet për të kërkuar që buxheti i përgjegjshëm gjinor (BPGj) të integrohet në mënyrë të plotë dhe sistematike në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027–2029, si dhe që RrGK dhe organizatat e shoqërisë civile të përfshihen në mënyrë aktive në procesin e hartimit dhe konsultimit publik të këtij dokumenti kyç.

Duke u bazuar në [Rregulloren \(QRK\) Nr. 17/2024 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës](#), theksojmë rëndësinë e konsultimit publik si mekanizëm thelbësor për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe përfshirje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Në këtë kontekst, përfshirja e shoqërisë civile veçanërisht organizatave me ekspertizë në barazi gjinore dhe BPGj është vendimtare për të siguruar që prioritetet fiskale të reflektojnë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.

Në përputhje me [Ligjin për Barazi Gjinore](#) dhe [zotimet e Kosovës](#) ndaj [Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm](#), veçanërisht [Treguesit 5.c.1](#), si dhe me [Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënien Financiare](#) (PEFA) [Kornizën Plotësuese për Menaxhimin e Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore](#), është thelbësore që KASH të përfshijë një Deklaratë Buxhetore Gjinore. Kjo deklaratë duhet të paraqesë qartë se si planifikimi fiskal afatmesëm adreson nevojat e grave, burrave, vajzave dhe djemve, si dhe të kontribuojë në monitorimin e progresit drejt barazisë gjinore.

Për më tepër, transparenca buxhetore kërkon publikimin e rregullt dhe të plotë të dokumenteve që lidhen me buxhetimin gjinor, përfshirë anekset e kërkuara nga qarkoret buxhetore. Deri më tani, mungesa e publikimit të qëndrueshëm të këtyre dokumenteve kufizon qasjen e publikut në informata dhe vështirëson vlerësimin e ndikimit të buxheteve në barazinë gjinore. Në këtë kuadër, RrGK kërkon nga Ministria e Financave (MF) që të ndërmarrë hapat në vijim:

- Të sigurojë përfshirjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në KASH 2027–2029 përmes një Deklarate të Buxhetit Gjinor të integruar.
- Të publikojë Deklaratën e Buxhetit Gjinor dhe të gjitha anekset përkatëse në mënyrë transparente dhe të qasshme për publikun.
- Të sigurohet që KASH-i i nënshtrohet një procesi të hapur, gjithëpërfshirës dhe të mirëstrukturuar të konsultimit publik, duke përfshirë RrGK-në dhe organizatat relevante të shoqërisë civile në fazat e hartimit dhe para miratimit.

Ne besojmë fuqishëm se këto masa do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë, drejtësisë dhe gjithëpërfshirjes së planifikimit buxhetor në Kosovë, duke forcuar njëkohësisht përputhshmërinë me kornizat ligjore dhe angazhimet ndërkombëtare për barazi gjinore dhe qeverisje të mirë.

RrGK mbetet e gatshme të kontribuojë me ekspertizën e saj në këtë proces dhe të bashkëpunojë ngushtë me MF për të avancuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në Kosovë.

Sinqerisht,

Igballe Rogova
Drejtoresh Ekzekutive
Rrjeti i Grave të Kosovës